



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë / Ministarstvo Pravde / Ministry of Justice

Kabineti i Ministrit të Drejtësisë-Ured Ministra Pravde-Office of the Minister of Justice

Nr.ref 143/2014

Prishtinë me, 27/03/2014

Në pajtim me nenin 8 dhe nenin 9, paragrafët 1, 4, 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 03/L-010 për Noterinë; nenin.8 të Udhëzimit Administrativ Nr. 09/2011 për Procedurën e Konkurimit dhe Përzgjedhjen e Zyrave Noteriale; duke u mbështetur në listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e pranueshmërisë në Shërbimin Noterial të Komisionit për Përzgjedhjen e Noterëve, si dhe duke vepruar në pajtim me nenin 8, nënparagrafin 1.4, të Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive,

Ministri i Ministrisë së Drejtësisë merr këtë:

VENDIM PËR EMËRIMIN E NOTERIT

1. Z. Fejzullah (Rrustem) Rexhepi emërohet të ushtrojë detyrën e Noterit.
2. Jurisdiksioni territorial i zyrës noteriale të z. Fejzullah Rexhepi përfshinë territorin e Komunës së Ferizajt.
3. Në pajtim me nenin 19, paragrafin 1, të Ligjit për Noterinë, obligohet i emëruari që brenda periudhës një (1) mujore nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, t'ia ofrojë Ministrisë së Drejtësisë dokumentin, i cili tregon dorëheqjen nga funksioni i tij aktual zyrtar.
4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Të emëruarit;
- Odës së noterëve;
- Arkivit.

Zëvendëskryeministër dhe Ministër i Drejtësisë



Prof. Dr. Hajredin Kuçi